

VENDIM
Nr. 765, datë 12.11.2014

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 46, DATË 29.1.2014, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN DHE MËNYRËN E ORGANIZIMIT E TË
FUNKSIONIMIT TË INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MJEDISIT, PYJEVE
DHE UJËRAVE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 11 e 51, pikat 2 e 3, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 8, e kreut III, “Mënyra e organizimit dhe e funksionimit të ISHMPU-së”, të vendimit nr. 46, datë 29.1.2014, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet si më poshtë vijon:

“8. Komisioni i ankimit ka në përbërjen e tij:

- Drejtorin e Inspektimit të Mjedisit;
- Drejtorin e Inspektimit të Pyjeve;
- Drejtorin e Inspektimit të Ujërave;
- Juristin e institucionit.

8.1 Komisioni mbledhet për shqyrtimin e ligjshmërisë së aktit ndaj të cilit është bërë ankim/kërkesë administrativ/e dhe merr vendim, në përputhje me procedurat dhe afatet e përcaktuara në ligjin nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, dhe në ligjin nr. 10279, datë 20.5.2010, “Për kundërvajtjet administrative”.

8.2 Në të gjitha rastet kur komisioni vlerëson pranimin e ankesës/kërkesës për shfuqizimin e vendimit administrativ, autoriteti përkatës, i cili ka marrë vendimin, me kërkesë të komisionit, duhet të jetë i pranishëm në mbledhjen e komisionit.

8.3 Për çdo vendim, komisioni njofton me shkrim zyrtarisht subjektin ankues/kërkues.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama